

URDHËR
Nr. 99, datë 25.8.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, neneve 22, pika 3, 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, koordinatorit pranë drejtorit të përgjithshëm, znj. Marçela Shahini, për shkak të mungesës me arsye të titullarit.
2. Delegimi i kompetencave përfshin vetëm fushën e veprimtarisë administrative të institucionit.
3. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë do të ushtrohen për periudhën nga data 26.8.2025 deri më datë 29.8.2025.
4. Këto kompetenca do të ushtrohen për periudhën e sipërcituar, me ndërprerjen vetëm në rastet kur kompetencat rimerren nga titullari i institucionit.
5. Për vendimmarrje të një rëndësie të veçantë, apo çështje të caktuara, znj. Marçela Shahini duhet të marrë miratimin paraprak nga drejtori i përgjithshëm nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.
6. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, koordinatori pranë drejtorit të përgjithshëm do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore të iniciuara, apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjes e çështjeve dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.
7. Ngarkohet znj. Marçela Shahini, koordinatori pranë drejtorit të përgjithshëm, për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Linda Pustina